Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vendin vakant pranë Drejtorisë së Meaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike pranë Sektorit Juridik në Rektoratin e UPT-së, si më poshtë:

Kritere të veçanta që duhet të plotësojë kandidati Specialist për Burimet Njerëzore.

a) Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Profesional" ose "Master Shkencor" për Shkenca Juridike.

b) Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune në këtë fushë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati Specialist për Burimet Njerëzore.

a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.

d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letrën e motivimit;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **18.11.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.